- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

2.

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	Afati
1.	Implementimi i nje sistemi te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes	1			
2.	Integrimi me sistemet ekzistuese (CRM/Billing, GIS)	1			
3.	Impelementimi dhe konfigurimi i infrastruktures virtuale hostuese	1			
4	Tableta	500			
5	Bluetooth printer	500			
6	Trajnim (train the trainers) ne	5			

	dite				
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Implementim i nje sistemi te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes

Afatet e ekzekutimit: 9 muaj sipas termave te references.

Nr.	Zeri	Sasia	Cmimi Njesi	Cmimi
1	Implementimi i nje sistemi te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes	1		
2	Integrimi me sistemet ekzistuese (CRM/Billing, GIS)	1		
3	Impelementimi dhe konfigurimi i infrastruktures virtuale hostuese	1		
4	Tableta	500		
6	Bluetooth printer	500		
7	Trajnim (train the trainers) ne dite	5		
			Cmimi pa TVSH	
			TVSH	
			Cmimi me TVSH	

PLANI I IMPLEMENTIMIT

Nr.	Emertimi i fazes / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9
1	Faza per gatitore per implementimin e sistemit	x								
2	Faza e realizimit te modulit te automatizimit te aktiviteteteve dhe proceseve te punes		x	x						
3	Faza e realizimit te modulit automatizimit te proceseve te punes te teknikut ne terren		x	x	x	x	x	x		
4	Faza e integritimit dhe testimit te sistemit							x	x	x
5	Trajnimi i perdoruesve									x
6	Marrja ne dorezim									x

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

3. PERMBAJTJA

FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT	2
Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit.....	2
NËNSHKRIMET MIRATUESE	2
Të dhënat e personit të Kontaktit:.....	3
PERMBAJTJA.....	Error! Bookmark not defined.
1. HYRJE	30
1.1. Perfituesi	5
1.2. Situata Aktuale ne Sektor	30
2. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA	31
2.1. Objektivi i Pergjithshem	31
2.2. Qellimi	31
2.3. Rezultatet qe Duhet te Arrihen nga Kontraktori	32
3. SUPOZIMET DHE RISQET	33
3.1. Supozimet e Projektit.....	33
3.2. Risqet.....	33
4. QELLIMI I PUNES	34
4.1.2 Hapesira gjeografike qe do te mbulohet	35
4.1.3 Grupet e synuara	35
4.1.4 Siguria e sistemit.....	35
4.1. Detyrat specifike	36
5. LOGJISTIKA DHE KOHA	37
5.1. Vendndodhja.....	37
5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit te Detyrave	37
6. RAPORTIMI.....	37
6.1. Kerkesat e Raportimit	37

6.2.	Dorezimi dhe Miratimi i Raporteve.....	38
7.	KOMUNIKIMI ME SISTEME TE TJERA.....	39
8.	Garancia	40
9.	KOMPONENTET PER NDERTIMIN E SISTEMIT	40
10.	AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TE PROJEKTIT	Error! Bookmark not defined.
11.	TE DREJTAT E KODIT TE APLIKACIONIT	41
12.	KERKESAT FUNKSIONALE.....	42
13.	KERKESAT TEKNIKE	57

ANEKSI 2: TERMAT E REFERENCËS

1. HYRJE

1.1. Situata Aktuale ne Sektor

Aktualisht, OSHEE nuk disponon nje sistem te integruar per automatizimin e proceseve te punes. Proceset operative, duke filluar nga planifikimi i aktiviteteve ne terren, alokimi i burimeve, monitorimi i vendodhjes dhe kohes se realizimit, raportimi mbi performancen dhe deri shfletimi dhe paraqitja pjeseve rezerve, kryhen kryesisht permes procedurave manuale, aplikacioneve te fragmentuara ose zgjidhjeve te pjesshme. Kjo gjendje shkakton mungese efikasiteti, veshtiresi ne koordinim, pamundesi per monitorim ne kohe reale, si dhe veshtiresi per te gjeneruar raporte te unifikuara menaxheriale, duke ndikuar negativisht ne cilesine e sherbimit ndaj klienteve.

Perfitimet e implementimit te nje sistemi te integruar per automatizimin e proceseve te punes ne OSHEE perfshijne:

- Rritja e efikasitetit operacional: optimizim i planifikimit te ekipeve dhe reduktim i kohes se reagimit ne terren nga ekipet teknike.
- Monitorim ne kohe reale: gjurmim i aktiviteteve dhe vendndodhjes se burimeve per te rritur transparencen dhe kontrollin.
- Permiresim i cilesise se sherbimit duke mundesuar zgjidhje me te shpejta te kerkesave dhe incidenteve nga klientet dhe per nevojat e OSHEE.

-
- Automatizim i proceseve qe do te sjellin reduktim i nderhyrjeve manuale dhe gabimeve te lidhura me proceset.
 - Raportim dhe analiza te avancuara duke krijuar nje baze te unifikuar per vendimmarrje operationale.
 - Shfletim dhe paraqitja e inventarit dhe pjeseve rezerve duke rezultuar ne uljen e kostove dhe garantim i disponueshmerise se materialeve.
 - Integrim nder-modular duke mundesuar lidhje me sistemet ekzistuese te CRM/Billing dhe GIS, per te mundesuar nje qasje te plote te automatizimit te sherbimit.
 - Mbeshtetje ne transformimin digjital duke mundesuar permiresimin e transparences, pergjegjshmerise dhe modernizimit te sherbimit.

2. OBJEKTIVAT, QELLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Pergjithshem

Ndertimi i nje sistemi te integruar per automatizimin e proceseve te punes qe do te perdoret per planifikimin, menaxhimin, optimizimin dhe monitorimin ne kohe reale te punonjesve ne terren. Sistemi duhet te mbeshtese procese qe lidhen me: krijimin e kerkesave per sherbim, planifikimin e burimeve, caktimin e detyrave, gjurmimin e punes, dhe raportimin.

2.2. Qellimi

Qellimi kryesor i ketij projekti eshte **implementimi i nje sistemi te integruar per automatizimin e proceseve te punes** ne OSHEE. Sistemi do te sherbeje si nje platforme unike qe do te garantoje **planifikim te centralizuar, alokim efikas te burimeve, monitorim ne kohe reale, dhe raportim gjithepershires** mbi aktivitetet operationale te stafit teknik ne terren.

Objektivi i tij eshte qe te mundesoje **optimizimin e sherbimeve ndaj konsumatoreve**, duke reduktuar kohen e reagimit, duke permiresuar transparencen e operationeve dhe duke garantuar nje **shfrytezim me te mire te burimeve njerezore dhe teknike**.

Ky projekt synon te:

- **Eliminoje fragmentimin** aktual te proceseve dhe perdorimin e zgjidhjeve te pjesshme apo manuale.
- **Automatizojte flukset e punes** per te reduktuar gabimet dhe per te rritur produktivitetin.

- **Siguroje integrim nder-modular** me sistemet ekzistuese te OSHEE (CRM Billing, GIS etj.).
- **Rrise transparencen dhe llogaridhenien**, duke vendosur standarde te qarta te performances per ekipet ne terren.
- **Mundesojte raportim dhe analitike te avancuar**, ne ndihme te vendimmarrjes menaxheriale.
- **Mbeshtese transformimin digjital** te OSHEE ne linje me praktikat me te mira dhe objektivat e reformave te sektorit energjetik.

Nepermjet implementimit ketij sistemi, OSHEE do te kaloje nga nje model operativ i bazuar kryesisht ne nderhyrje manuale dhe koordinim te shperndare, drejt nje **ekosistemi te automatizuar, te integruar dhe te orientuar tek klienti**, duke kontribuar ndjeshem ne **rritjen e besueshmerise se rrjetit dhe permiresimin e cilesise se sherbimit**.

2.3. Rezultatet qe Duhet te Arrihen

Ofruesi do te kete pergjegjesine te siguroje nje zgjidhje te plote, funksionale dhe te integruar per automatizimin e proceseve te punes per OSHEE. Ne perfundim te kontrates, pritet qe kontraktori te dorezoje keto rezultate konkrete:

1. **Implementimi i nje sistemi te integruar** per automatizimin e proceseve te punes
 - Projektim dhe zhvillim i nje platforme te centralizuar, e cila te mbuloje proceset kryesore te automatizimit te proceseve te punes te teknikeve ne terren: planifikim, alokim burimesh, automatizim te proceseve te puneve ne terren, monitorim ne kohe reale dhe raportim.
 - Sistemi fleksibel dhe i zgjerueshem sipas nevojave te OSHEE.
 - Sistemi duhet te mbeshtese auditim te brendshem, kontroll te performances dhe gjurmueshmeri te plote te aktiviteve.
2. **Integrimi me sistemet ekzistuese (CRM/Billing, GIS, MAXIMO)**
 - Zhvillim dhe konfigurim i nderfaqeve (APIs me sherbime web) per te garantuar shkembim te sigurt dhe ne kohe reale te te dhenave ndermjet sistemit te menazhimit te proceseve te punes dhe sistemeve aktualisht ekzistuese operuese ne OSHEE.
3. **Implementimi dhe konfigurimi i infrastruktures virtuale hostuese**

-
- Projektim dhe ngritje e infrastruktures IT (virtuale, on-premise ne datacenterin e OSHEE) per te instaluar sistemin e integruar per automatizimin e proceseve te punes.

4. Furnizimi dhe vendosja ne perdorim te pajisjeve mobile – Tableta

- Pajisje mobile per perdorim ne terren per marrje dhe raportim te puneve ne kohe reale.

5. Furnizimi dhe konfigurimi i pajisjeve shtese – Bluetooth Printer

- Pajisje printeri portative, te lidhura me tabletat per gjenerimin te dokumenteve operative direkt ne terren.

6. Trajnim “Train the Trainers”

- Program trajnimi per perdoruesit kyç (key users) dhe administratoret e sistemit.
- Pergatitja e materialeve te dokumentimit teknik (instalimit dhe administrimit) dhe manualeve te perdorimit.
- Sigurim i trajnimit per trajneret e OSHEE, per te garantuar **transferimin e dijes** dhe autonomine ne perdorim.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

- Stafi i autoriteti kontraktor, operatorit ekonomik dhe perfituesit te jene te pavarur ne punen e tyre dhe te gjindshem ne çdo rast.
- Stafi i autoriteti kontraktor, perfituesit dhe operatorit ekonomik duhet te jene komunikues dhe bashkepunues me njeri-tjetrin.
- Stafi i autoriteti kontraktor, perfituesit dhe operatorit ekonomik te jete i afte te gjeje konsensusin ne rastet kur kerkohet.
- Stafi i autoritetit kontraktor / perfituesi do te vere ne dispozicon te personelit te operatorit ekonomik te gjithe dokumentat, rregulloret, procedurat e nevojshme.
- Informacioni i shkembyer midis stafit te paleve mbetet konfidencial mes paleve

3.2. Rrisqet

- Vonese ne zbatimin e projektit si pasoje e mos koordinimit te punes mes stafit te perfshire.
- Eksperienca e stafit te operatorit ekonomik fitues ne projekte te tilla.

-
- Dokumentimi jo i mire i sistemit.
 - Mos respektimi i afateve kohore nga operatori ekonomik fitues.

4. QELLIMI I PUNES

Qellimi i ketij projekti eshte ndertimi dhe implementimi i nje **sistemi te integruar per automatizimin e proceseve te punes ne terren**, i cili do te mundesoje nje kontroll te plote dhe transparent mbi aktivitetet operative ne terren dhe koordinimin e tyre me sistemet ekzistuese. Ky sistem synon te rrise efikasitetin, te ule kostot operative, te permiresoje cilesine e sherbimeve ndaj klientit dhe te siguroje nje menaxhim me te mire te burimeve njerezore dhe teknike te OSHEE.

Ketu perfshihet:

- **Implementimin e nje sistemi te integruar**
 - Implementim dhe vendosje ne funksion e nje platforme te centralizuar qe mbulon planifikimin, shperndarjen e puneve te stafit teknik ne terren, monitorimin ne kohe reale dhe raportimin analitik.
 - Pershtatje me proceset aktuale te OSHEE duke shmangur kufizimet teknologjike dhe duke mundesuar zgjerim te ardhshem.
- **Integrimin me sistemet ekzistuese (CRM/Billing, GIS)**
 - Garantim i shkembimit te vazhdueshem te te dhenave ndermjet sistemin objekt prokurimi dhe sistemeve te tjera kyçe te OSHEE.
 - Sigurim i nje ekosistemi te unifikuar per te permiresuar vendimmarrjen dhe sherbimin ndaj klientit.
- **Implementimin dhe konfigurimin e infrastruktures virtuale hostuese**
 - Ngritje dhe konfigurim i platformes se nevojshme teknologjike per funksionimin e qendrueshem dhe te sigurt te sistemit.
 - Sigurim i redundances, sigurise se te dhenave dhe performances se larte.
- **Furnizimin dhe vendosjen ne perdorim te pajisjeve mobile – Tableta**
 - Ofrimi i pajisjeve te pershtatshme per perdoruesit ne terren per kryerjen dhe raportimin e detyrave.

- **Furnizimin dhe konfigurimin e pajisjeve –Bluetooth Printer**

- Mundesimi i gjenerimit të menjehershëm të dokumenteve direkt nga terreni, duke rritur shpejtësinë dhe transparencën e proceseve.

- **Trajnimin e përdoruesve kyç përmes programit “Train the Trainers”**

- Përgatitje e stafit të brendshëm për përdorimin dhe administrimin e sistemit.

4.1.2 Hapesira gjeografike që do të mbulohet

Drejtorite Rajonale të OSHEE, stafi teknik që do të mundësojë dispecimin e punëve në terren.

4.1.3 Grupet e synuara

- Stafi teknik në terren të OSHEE që do të përdorin sistemin

4.1.4 Siguria e sistemit

Sistemi duhet të ofrojë minimalisht:

- Mekanizmi i Autentikimit - duhet të sigurojë një mekanizëm për sigurinë që përfshin Autentikimin dhe autorizimin.
- Identitetet dhe të drejtat - duhet të ofrojë një regjister qendror për të gjitha rolet, përdoruesit dhe të drejtat e tyre.
- Mekanizmi i autorizimit - duhet të sigurojë një mekanizëm autorizimi në bazë të përdoruesit dhe roleve, duhet të lejojë apo refuzojë aksesin në funksionalitetet e ndryshme të sistemit, bazuar në anëtarësimin e përdoruesve për çdo rol.
- Mekanizmi i auditimit - duhet të ruajë gjurmët e përdoruesve të regjistruar të cilët modifikojnë të dhënat në bazën e të dhënave, duhet të sigurojë gjurmimin për të gjithë veprimet që kanë lidhje me krijimin, miratimin, refuzimin, dhe pezullimin e regjistrimit.

Sistemi që do të ndërtohet duhet të ketë një ndërfaqe web, të lehtë në përdorim dhe pa probleme kur aksesohet nga shumë përdorues njëherësh.

Sistemi duhet të sigurojë akses të sigurtë për të gjithë përdoruesit e tij.

Do të duhet të sigurohet akses i mbrojtur dhe i kontrolluar në sistem. Sistemi duhet të implementojë një modul të dedikuar që do të duhet të ofrojë:

- Menaxhim i përdoruesve dhe roleve
Çdo përdorues do të duhet të ketë një identitet unik dhe do t'i caktohen role të përcaktuara qartë (p.sh. teknik terreni, dispeçer, administrator). Ky modul do të ruajë informacion mbi të drejtat e aksesit, duke garantuar që çdo përdorues ka qasje vetëm tek funksionalitetet përkatëse.

- Autentikim me JWT (JSON Web Token)

Autentikimi i përdoruesve do të realizohet përmes mekanizmit standarte JWT, i cili do të sigurojë:

- Gjenerimin e një token-i unik pas autentikimit me sukses.
- JWT Tokens duhet të jenë të vlefshëm për një periudhë kohore të përcaktuar të konfigurueshme (p.sh 1 orë ose 24 orë)
- Përfshirjen e të dhënave për identitetin, rolin dhe afatin e vlefshmerisë së sesionit.
- Validimin e token-it, duke eliminuar nevojën për sesione të ruajtura në server (stateless authentication).

- Autorizim bazuar në role (Role-Based Access Control – RBAC)

Pas validimit të token-it JWT, sistemi do të lejojë ose refuzojë qasjen në burimet e kërkuara, bazuar në rolin e përdoruesit. Kjo do të ofrojë granularitet në kontrollin e aksesit.

- Dy Faktor Autentikimi (2FA)

Për të rritur nivelin e sigurisë, përdorues të vecantë, pas autentikimit fillestar do të duhet të konfirmojnë hyrjen përmes një kodi verifikimi të gjeneruar automatikisht dhe të dërguar me email. Procesi do të duhet të jetë si vijon:

- Përdoruesi fut kredencialet (username & password).
- Sistemi verifikon kredencialet dhe gjeneron një kod 2FA unik (One-Time Password – OTP).
- Kodi dërgohet në adresën e email-it të përdoruesit.
- Përdoruesi duhet të fusë këtë kod për të përfunduar procesin e autentikimit.
- Pas suksesit, sistemi gjeneron JWT token-in për akses në API.

- Auditim dhe gjurmueshmeri

Moduli do të ruajë log-e për çdo autentikim, gjenerim token-esh dhe përdorim të 2FA, për të mundësuar analize retrospektive dhe mbrojtje ndaj abuzimeve.

4.1. Detyrat specifike

Në fazën e parë, fillimisht do të analizohet situata e procedurave administrative dhe baza ligjore. Do të shqyrtohen proceset e punës.

Faza e dyte eshte ajo e zhvillimit te proceseve per implementimit te sistemit duke marre parasysh kerkesat sipas termave te references. Operatori Ekonomik do te duhet te realizoje implementimin e sistemit duke marre parasysh edhe analizen e cila do te realizohet ne fazen e pare.

Ne *fazen e trete* do te behet testimi i sistemit dhe funksionaliteteve te tij. Kur sistemi te jete gati per pune dhe funksional do te filloje trajnimi i personelit qe do te punoje ne kete sistem.

Ne *fazen e katert*, pasi sistemi eshte dorezuar, do te behet kalimi i sistemit ne ambjentin real te punes.

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Vendndodhja e bazes operative per sistemin do te jete Datacenteri i OSHEE ne nje infrastrukture te virtualizuar qe do te vihet ne dispozicion nga OSHEE.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit te Detyrave

Si date fillimi e projektit do te merret “Data e nenshkrimet te kontrates” dhe periudha e implementimit do te jete 9 (muaj) nisur nga kjo date.

6. RAPORTIMI

6.1. Kerkesat e Raportimit

Kontraktuesi do te paraqese raportet e meposhtme ne shqip, ne original dhe 2(dy) kopje:

- Raporti Fillestar prej maksimumi 15 faqesh duhet te prodhohet brenda 1 (nje) muaji nga fillimi i implementimit. Ne raport Kontraktuesi duhet te pershkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi ne mbledhjen e te dhenave, çdo veshtiresi te pritura ose te hasura perveç programit te punes apo udhetimeve te stafit. Kontraktuesi duhet te vazhdoje me punen e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues te dergoje komente mbi raportin fillestar
- Drafti i raportit perfundimtar i perbere prej maksimumi 20 (njetzet) faqesh (teksti kryesor, duke perjashtuar anekset) Ky raport duhet te dorezohet jo me vone se nje muaj para perfundimit te periudhes se implementimit te detyrave.
- Raporti final me te njejtat specifika si drafti i raportit perfundimtar, inkorporimin e komenteve te pranuar nga palet ne draft raport. Afati i fundit per dergimin e raportit

perfundimtar eshte 5 (pese) dite pas marrjes se komenteve ne draft raportin perfundimtar. Raporti duhet te permbaje nje pershkrim mjaftueshem te detajuar te opsioneve te ndryshme. Analizat e detajuara qe i mbeshtetin rekomandimet do te prezantohen ne anekset ne raportin kryesor. Raporti perfundimtar duhet te sigurohet se bashku me faturen perkatese.

6.2. Dorezimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i permendur me siper duhet t'i dorezohet personave pergjegjes te OSHEE te identifikuar ne kontrate te cilet do te jene pergjegjes per aprovimin e raporteve.

Sistemi duhet te jete ne gjendje te ekspozoje te dhena nepermjet API (Application Interfaces).

- CRM dhe Billing
- Sistemin e inventarit
- GIS

APIs (Application Programming Interface) do te perbejme mekanizmin themelor per shkembimin e te dhenave midis sistemit objekt prokurimi dhe sistemeve ekzistuese te OSHEE qe do te duhet te nderveproje. Ne nje arkitekture te shperndare, API-te do te mundesojne nderveprim transparent, duke lejuar aplikacionet te konsumojne sherbime te njera-tjetres ne menyre te standardizuar, te sigurt dhe te pershtatshme per zgjerim.

Do te duhet te mundesohet:

- Perdorimi i protokolleve si HTTP/HTTPS dhe formateve te dhenash te standardizuara (JSON, XML).
- Autentikim dhe autorizim permes mekanizmave si JWT.
- Mundesi per te shtuar sherbime te reja pa ndikuar ne funksionalitetet ekzistuese.
- Integrim nder-modular duke mundesuar integrim me sisteme te jashtme si CRM, Billing, GIS etj

API-te do te duhet te kene arkitekture SOA dhe do te ofrohen si sherbime te pavarura, te aksesueshme permes rrjetit.

Çdo API do te duhet te ndertohet per te qene i pavarur dhe i rishfrytezueshem ne disa aplikacione.

Çdo API do te duhet te jete i kapsuluar (encapsulated), duke fshehur logjiken e brendshme.

Çdo API do te duhet te jete i aksesueshem permes nderfaqeve te qarta dhe te dokumentuara.

API-te me arkitektura SOA do te mundesojne integrimin e sistemeve ekzistuese (CRM, Billing, GIS) permes sherbimeve te ekspozuara, duke siguruar qe proceset te lidhen ne menyre koherente dhe te mbeshtesin transformimin digjital.

API-te do te duhet te mbeshtesin REST web service duke perdorur operacionet standarde si:

- GET (lexim i te dhenave),
- POST (krijim i te dhenave),
- PUT (ndryshim i te dhenave),
- DELETE (fshirje e te dhenave).

Zhvillimi i API-ve te bazuara ne REST dhe JSON, te implementuara dhe te organizuara sipas parimeve SOA, do te sigurojne sigurojne fleksibilitet dhe zgjerueshmeri per nevoja te ardhshme, efikasetet dhe siguri per shkembimin e te dhenave, duke rritur efikasetetin operacional dhe transparencen.

Per caktimi i sakte i API-ve (data structure) do te realizohet gjate fazes se analizes.

7. Garancia

Duhet te ofrohet per 1 vit

8. KOMPONENTET PER NDERTIMIN E SISTEMIT

Nr.	Zeri	Sasia	Cmimi Njesi	Cmimi
1	Implementimi i nje sistemi te integruar per menaxhimin dhe automatizimin e proceseve te punes	1		
2	Integrimi me sistemet ekzistuese (CRM/Billing, GIS)	1		
3	Impelementimi dhe konfigurimi i infrastruktures virtuale hostuese	1		
4	Tableta	500		
6	Bluetooth printer	500		
7	Trajnim (train the trainers) ne dite	5		
			Cmimi pa TVSH	
			TVSH	
			Cmimi me TVSH	

ANEKSI 3: PLANI I IMPLEMENTIMIT

Nr.	Emertimi i fazes / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7	M8	M9
1	Faza per gatitore per implementimin e sistemit	x								
2	Faza e realizimit te modulit te automatizimit te aktiviteteve dhe proceseve te punes		x	x						
3	Faza e realizimit te modulit automatizimit te proceseve te punes te teknikut ne terren		x	x	x	x	x	x		
4	Faza e integritimit dhe testimit te sistemit							x	x	x
5	Trajnimi i perdoruesve									x
6	Marrja ne dorezim									x

9. TE DREJTAT E KODIT TE APLIKACIONIT

Te gjitha te drejtat mbi dokumentacionin teknik qe ka te beje me implemtnimit dhe konfigurimet software nga Operatori Ekonomik fitues, menyren e konfigurimeve, skema etj. do t'i perkasin Autoritetit Kontraktor.

10.KERKESAT FUNKSIONALE

Sistemi te integruar per automatizimin e proceseve te punes duhet te jete modular.

Moduli: Menaxhimi i Teknikeve dhe Profileve

Moduli i Menaxhimi i Teknikeve (stafit ne terren) dhe Profileve perkatese, do te duhet te trajtojte funksionalitete te nevojshme per menaxhimin e proceseve specifike. Ky modul do te siguroje nje baze te forte per organizimin dhe kontrollin e proceseve ne nje sistem te integruar per automatizimin e proceseve te punes.

Ky modul do te duhet te fokusohet ne menaxhimin e stafit (teknikeve dhe punonjesve pergjegjes te tyre) dhe profileve te perdoruesve, duke siguruar qe çdo punonjes te kete rolin, te drejtat dhe pergjegjesite e qarta brenda sistemit.

Procesi fillon me krijimin e profileve individuale ku administratori i sistemit regjistron te dhena baze si emri, pozicioni, departamenti dhe aftesite profesionale. Keto te dhena do te duhet qe te perdoren me vone per te optimizuar shperndarjen e detyrave.

Nje element thelbësor do te duhet te jete dhe kategorizimi i burimeve ne baze te specializimeve dhe certifikimeve. Kjo do te mund te lejoje qe gjate alokimit te puneve te caktohet punonjesi me i pershtatshem per nje aktivitet specifik ne terren.

Moduli do te duhet te perfshije gjithashtu menaxhimin e disponueshmerise te burimeve teknike ne kohe reale.

Nje proces tipik perfshin: regjistrimi i nje punonjesi te ri → verifikimi i dokumenteve dhe certifikatave → caktimi i rolit ne sistem → konfigurimi i te drejtave te aksesit → lidhja me grupin perkates te punes.

Sistemi do te duhet te mbeshetese flukse aprovimi per raste te veçanta si ndryshimi i rolit, zgjerimi i pergjegjesive ose transferimi ne nje departament tjeter.

Gjithashtu, ky modul do te duhet te sherbeje si burim qendror per auditim dhe gjurmueshmeri. Çdo ndryshim ne profile do te duhet te ruhet me date, ore dhe perdoruesin qe e ka kryer.

Ne praktike, ky modul do te ndihmoje menaxheret te kene nje pasqyre te plote mbi kapacitetet e ekipit dhe te planifikojne me mire shperndarjen e ngarkeses se punes.

Moduli: Planifikimi dhe Optimizimi i Orarit

Ky modul do të duhet të fokusohet në planifikimin dhe alokimin e detyrave, duke përdorur të dhënat e kapacitetit të punonjësve dhe kërkesat e punës për të siguruar eficiencë maksimale.

Procesi do të duhet të fillojë me identifikimin e të gjitha detyrave të reja që hyjnë në sistem, të cilat mund të vijnë nga burime të ndryshme si kërkesa të klienteve, punë të planifikuara ose ndërhyrje emergjente në rrjet.

Secila detyrë do të duhet të karakterizohet nga parametra si: lloji i punës, urgjencia, afati kohor, afatesite e nevojshme dhe vendodhja. Këto parametra do të duhet të përdoren nga sistemi për të përcaktuar burimet (stafet teknike në terren) me të pershtatshme.

Një element thelbësor i këtij moduli do të duhet të jetë algoritmi i optimizimit, i cili merr parasysh distancën gjeografike, ngarkesën aktuale të punonjësve dhe disponueshmërinë e tyre për të minimizuar kohën e reagimit dhe kostot operative.

Fluksi tipik: krijimi i detyrës → kategorizimi → kontrolli i burimeve të disponueshme → sugjerimi i alokimit → miratimi nga menaxheri → njoftimi i punonjësit.

Sistemi do të duhet të ofrojë mundësinë e rishpërndarjes dinamike të detyrave në rast vonesash, anulimesh ose emergjencash të reja. Kjo do të mund të lejojë OSHEE që të ruajë fleksibilitet dhe të shmangë ndërprerjet në shërbim.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij moduli do të duhet të jetë transparencja: çdo punonjës do të duhet të ketë mundësinë që të shohë detyrat e planifikuara, orarin dhe prioritetet në kohë reale përmes ndërfaqes së tij të përdoruesit.

Ky modul do të duhet të jetë i lidhur ngushtë me monitorimin e terrenit, pasi çdo ndryshim në statusin e detyrave do të duhet të reflektohet menjëherë dhe përdoret për të riplanifikuar në mënyrë dinamike.

Moduli: Automatizimi i Aktiviteteve dhe proceseve të punës (moduli qendror)

Automatizimi i Aktiviteteve dhe proceseve të punës (modul qendror) kërkohej si produkt i gatshëm.

Ky modul do te duhet te trajtoje funksionalitete te nevojshme per automatizimin e proceseve specifike. Ky modul do te siguroje nje baze te forte per organizimin dhe kontrollin e proceseve te punes te teknikeve ne terren (te cilet do te duhet te perdorim moduln web mobile nepermjet tabletave).

Ky modul do te kete per qellim sigurimin e monitorimit te te gjithë punonjesve te terrenit dhe statusit te detyrave te tyre.

Cdo punonjesi i terrenit do te jete i pajisur me nje web aplikacion qe raporton statusin e detyrave te caktuara.

Te dhenat do te duhet te mblidhen dhe te paraqiten ne nje panel qendror qe i lejon dispecerat /menaxheret te shohin se cilat detyra jane ne progres dhe cilat jane perfunduar.

Sistemi do te duhet te mundesoje gjenerimin automatik te alarmeve kur nje kerkese per sherbim nuk realizohet ne kohen e percaktuar ose kur ndodh nje ngjarje e paparashikuar.

Fluksi tipik i ketij moduli: marrja e te dhenave nga terreni → perpunimi i tyre → vizualizimi ne harte ose panel → gjenerimi i raporteve.

Nje funksionalitet i rendesishem eshte vizualizimi grafik i te dhenave, ku dispeceri/menaxheri mund te shohe rrugët e ndjekura, kohen e kaluar ne çdo detyre dhe perqindjen e progresit.

Sistemi gjithashtu do te duhet te ofroje mundesi per komunikim direkt ndermjet menaxherit dhe punonjesit te terrenit permes mesazheve ose njoftimeve te integruara ne sistem.

Ky modul eshte i lidhur me moduln e planifikimit, pasi çdo ndryshim i statusit te detyres shfrytezohet per te riplanifikuar detyrat ne menyre dinamike.

Moduli i qendror per automatizimin e aktiviteteve dhe proceseve te punes kerkohet si produkt i gatshem me licensa per 50 perdorues konkurrent.

Rezultati kryesor i ketij moduli eshte rritja e transparences, ulja e kohes se reagimit dhe permiresimi i cilesise se sherbimit ndaj klienteve.

Moduli : Monitorimi ne Kohe Reale dhe Vendodhja

Ky modul do te duhet te fokusohet ne mundesimin e komunikimit efektiv ndermjet punonjesve te terrenit, menaxhereve dhe klienteve permes kanaleve te ndryshme.

Procesi do të duhet të nisë me gjenerimin automatik të njoftimeve për çdo ndryshim të rendesishëm në statusin e detyrës, si fillimi, përfundimi ose vonesat e papritura.

Sistemi do të duhet të mbështesë komunikimin shumëkanalësh, duke përfshirë njoftime në sistem dhe njoftime brenda aplikacionit web mobile.

Fluksi i këtij moduli do të duhet të përfshijë: identifikimi i ngjarjes → gjenerimi i njoftimit → përcaktimi i stafit teknik → shpërndarja e njoftimit.

Një element kyç do të duhet të jetë personalizimi i njoftimeve, ku përmbajtja do të duhet të përshtatet sipas rolit të marrësit (punonjës, dispecer/menaxher).

Cdo ndryshim i statusit nga moduli i monitorimit ose planifikimit do të duhet që të trigerojë një njoftim automatik.

Sistemi do të duhet të lejojë gjurmimin e të gjitha komunikimeve për auditim ose analize të mëvonshme.

Rezultatet kryesore të këtij moduli do të jenë përmirësimi i koordinimit dhe rritja e cilësisë së shërbimit.

Ky modul do të duhet të ofrojë aftësi për të mbikëqyrur të gjitha aktivitetet operative dhe pozicionin gjeografik të burimeve (teknike terreni), duke mundësuar ndërhyrje proaktive dhe rritje të efikasitetit operacional.

Përditësimi i të dhënave do të duhet të ndodhë në intervale të shkurtra shkurtra kohore

Burimet do të duhet të paraqiten në një hartë, ku vendodhja e tekniku/automjeti shfaqet me ikone identifikuese.

Ngjyrat ose simbolikat do të duhet të ndryshojnë sipas statusit të aktivitetit (p.sh. në punë, në rrugë, në pushim, emergjencë).

Moduli do të duhet të ketë opsione për filtrimin që të lejojnë operatorët të shohin vetëm burimet relevante për një rajon.

Moduli do të duhet të mundësojë gjurmueshmeri historike për analize të post-eventeve (p.sh. për të parë nëse janë respektuar kohët për kryerjen e një detyre).

Duke pare pozicionin e burimeve, dispeceri do të mund të zgjedhë teknikun më afër për të trajtuar një kërkesë të re. Kjo do të zvogëlojë kohën e përgjigjes dhe kostot operative.

Moduli do të duhet të mundësojë për paraqitjen e vendndodhjes aktuale të burimeve dhe numrin e detyrave aktive në një zonë.

Ky modul do të duhet lidhet ngushtë me Modulin “Planifikimit dhe Orarit” dhe Modulin “Menaxhimi i Punës në Terren”.

Te dhenat e vendndodhjes do të duhet të përdoren për të përditësuar statusin e detyrave dhe për të optimizuar oraret.

Integrimi me sistem të tipit GIS do të sigurojë mbulim të saktë gjeohapësor.

Fluksi i procesit:

Kërkesa e klientit → Qendra e kontrollit → Alokimi i teknikut më afër

→ Monitorimi në hartë → Përfundimi i detyrës → Raportim

Moduli: Shfletimi dhe paraqitja e Inventarit dhe Pjesëve Rezerve

Ky modul do të ketë si objektive të garantuara që çdo ekip pune në terren dhe çdo qender logjistike të ketë **pjesët, materialet dhe pajisjet** e nevojshme në kohën e duhur dhe me koston optimale.

Proceset do të duhet të mbulojnë gjithë ciklin e inventarit, nga planifikimi, magazinimi, shpërndarja, përdorimi dhe rikthimi, deri të raportimi për nivelin e stokut. Te dhenat do të duhet të plotësohen me anë të një API (web service) që vihet në dispozicion nga OSHEE.

Operatori ekonomik do të duhet të ndërtojë klientin e API (web service client) për tërheqjen/marrjen e të dhënave të inventarit. Moduli do të duhet të lejojë dhe regjistrimin manual të artikujve të inventarit.

Në këtë modul do të duhet të analizohen kërkesat historike për materiale/pjesë të inventarit.

Në këtë modul do të duhet të mbahet/përcaktohet niveli minimal i stokut.

Në këtë modul do të duhet të realizohet përcaktimi i artikujve kritike dhe pjesëve rezerve.

Do te duhet te realizohet nje koordinimin me moduln e planifikimit per te bere lidhjen me punet e planifikuara me nevojen per materiale/pjese kembimi.

Do te duhet te realizohet percaktimi i artikujve qe do te duhet te perdoren nga stafi teknik ne terren.

Ne kete modul cdo artikull inventari do te duhet te jete i identifikueshte me nje numer unik artikulli. Ne kete modul do te duhet te shfletohet vendodhja(location) e materialit/pjeses.

Ne kete modul do te duhet te mundesohet qe punonjesit ne terren te mund te kerkojne materile/pjese permes sistemit.

Ne kete modul do te duhet te regjistrohen levizjet e materialeve/pjeseve nga nje magazine ne nje tjeter.

Ne modul cdo perdorim i pjeseve do te duhet te regjistrohet me numrin e kerkesen per sherbim perkatese.

Ne modul do te duhet te mundesohset qe nese materiali/pjesa nuk perdoret, kthehet ne magazine dhe regjistrohet si rikthim.

Ne modul do te duhet te mundesohset regjistrimi i pjeseve te demtuara ose te paperdorshme dhe shenjimi i tyre si “scrap” dhe dalin nga stoku.

Ne modul do te duhet te mundesohset verifikimi i niveleve te stokut.

Ne modul do te duhet te mundesohset per gjenerim alarmesh(p.sh email) kur stoku i nje artikulli bie nen nivelin minimal.

Ne modul do te duhet te mundesohset procesi i menaxhimit te vendodhjeve(location) te magazines.

Moduli do te duhet te mundesoje per raporte mujore/javore:

- Nivelet e stokut.
- Materialet/pjeset me te perdorura.
- Artikujt me levizshmeri te ulet.
- Artikujt ne risk mungese.

Moduli: Automatizimi i proceseve te punes te teknikut ne terren

Moduli i automatizimit te proceseve te punes te teknikut ne terren **do te duhet te jete web mobile dhe duhet te aksesohet nga pajisjet mobile te tipit tableta.**

Moduli i **teknikut ne terren** synon te mbeshtese OSHEE qe ofrojne sherbime ne terren ne menyre me efikase, te reduktojne kostot operative dhe te permiresojne ndjeshem kohen e pergjigjes ndaj klienteve dhe defekteve te rrjetit te shperndarjes.

Moduli i **teknikut ne terren** do te duhet te mundesoje:

- **Rritjen e efikasitetit operacional**
 - Automatizimin e krijimit, shperndarjes dhe te detyrave te teknikeve ne terren.
 - Reduktimi i kohes se ciklit te sherbimit (nga marrja e kerkeses deri te perfundimi i saj).
- **Permiresimin e cilesise se sherbimit ndaj klientit**
 - Sigurimin e informacionit ne kohe reale per statusin e sherbimit nga tekniket ne terren.
 - Mundesine per te gjeneruar raporte dhe per te kapur nenshkrimin e klientit ne vend nga tekniket ne terren.
- **Optimizimi i perdorimit te burimeve**
 - Planifikimim me te mire te teknikeve sipas aftesive, lokacionit dhe disponueshmerise.
 - Shfletimi dhe paraqitja e inventarit dhe pjeseve rezerve.
- **Reduktimi i kostove operative**
 - Eliminimin e gabimeve manuale dhe duplikimit te punes.

Moduli i **teknikut ne terren** do te duhet te mundesoje per menaxhimi e sherbimeve dhe detyrave.

Moduli do te duhet te mundesoje per shfletimin dhe trajtimin e kerkesave per sherbim (Service Requests)

Moduli do te duhet te lejoje shfletimin dhe trajtimin e kerkesave te reja nga qendra e thirrjeve, ose integrimi te jashtme (Billing CRM ekzistues i OSHEE).

Kerkesat ne kete modul do te duhet te perfshijne te dhena te detajuara: klient, adrese, pajisje/produkt, kontrate, pershkrim te problemit.

Ne modul do te te duhet te ekzistojë mundësia për të lidhur kerkesen për shërbim me kontrata aktive ekzistuese.

Moduli do te duhet te lejoje krijimin dhe shfletimin e detyrave (tasks)

Ne modul do te duhet te mundesohet qe per cdo kerkese per shërbim te mund te krijohet nje ose me shume detyra (tasks).

Detyrat (tasks) do te duhet te gjenerohen automatikisht ose manualisht nga dispeçeri.

Ne kete modul detyra duhet te permbaje: pershkrim, status, prioritet, vendodhje, orar dhe resurse te alokuara.

Ne modul do te duhet te konfigurohet/implementohet nje fluks pune(workflow) i paracaktuar për sa i përket statusit të detyres(task):

I caktuar → I pranuar → Ne Proces → Perfunduar → I mbyllur.

Ne modul do te duhet te mundesohet konfigurimi i statusit sipas nevojave te proceseve te punes.

Kur nje detyre kalon nga nje status ne nje tjetër keto kalime do te duhet te jene te kontrolluara dhe te gjurmueshme.

Ne modul do te duhet te mundesohet menaxhimi i detyrave personale te teknikut ne terren.

Ne modul do te duhet te mundesohet tekniket te mund te krijojne detyra personale për aktivitetet qe nuk origjinojne nga dispeçeri.

Ne modul do te duhet te mundesohet shfletimi i historikut te shërbimeve qe tekniku ka kryer. Moduli duhet te shfaqë historikun e plote të shërbimeve sipas tipit të shërbimit.

Historiku duhet te perfshije: kerkesa te meparshme, detyra te mbyllura dhe rezultatet e nderhyrjes.

Ne kete modul do te duhet te ofrohet opsion kerkimi dhe filtrimi (p.sh., sipas periudhes kohore, tipit te sherbimit).

Moduli do te duhet te mundesoje debriefim dhe raportim te teknikeve ne terren

Moduli do te duhet te mundesoje debriefim te udhetimit te teknikut per kryer nje kerkese per sherbim apo nje detyre te caktuar

Moduli do te duhet te mundesoje debriefim te punes te teknikut

